



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 13, datë 04.10.2024

**PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“HOTEL 1 DHE 9 KATE MBI TOKË ME 2 KATE NËNTOKË”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË DURRËS**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të subjektit zhvillues shoqërinë “Coral-Royal” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Hotel 1 dhe 9 kate mbi tokë me 2 kate nëntokë”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë “Coral-Royal” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Vendimi Nr. 36, datë 02.04.2024 i Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin: “Apart-hotel dhe shërbime turistike 8 dhe 9 kate me podrum”, me vendndodhje në Bashkinë Durrës”, shfuqizohet.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 12/01/2025